



Strategjia Gjermane dhe ajo shqiptare për Energjinë !

Gjithëherë kur flitet për energjinë, të vjenë në mendje kjo thënje vazhdimisht e më aktuale e nobelistit Laughlin:

"Kriza energjetike do të vijë dhe do të jetë e tmerrshme."

Kur errësohet, ne ndezim dritën. Kur bëhet ftohtë, ne ngrohemi.

Sa herë që kemi nevojë për energji, për industrinë dhe teknologjinë globale, ne i shërbejmë vetes, në çdo kohë.

Por shpejt karburantet e tokës, si: qymyri, gazi, nafta dhe uranumi, harxhohen përfundimisht. I fundit fik dritën! Dhe pastaj?

Fizikani nobelist, Robert B. Laughlin, për të ardhmen e furnizimit tonë me energji.

"Sigurimi i paqes, mbrojtja e mjedisit dhe siguria e furnizimit me energji arrihen vetëm me kalimin e vazhdueshëm në energji të ripërtitëshme. Misioni politik i kohës sonë duhet të jetë: Solar për paqe". (Gudrun Vinzig).

Është e vërtetë absolute se nëse burimet e pashterrshme dhe të ripërtitëshme të energjisë do të mundeshin të shfrytëzoheshin në shkallë të mjaftueshme që ti plotsonin nevojat e njerzimit për energji, veq paqës në botë, do të sillnin edhe mbrojtje të klimës dhe mjedisit.

Por është po aq e vërtetë se jo vetëm në të kaluarën, por edhe tani nuk teprohet nëse thuhet se, bazë e pathënë, pothuajse e të gjitha luftërave mes popujve dhe vendeve ka qenë dhe mbetet përvetësimi i burimeve fosile (nafta, gazi, qymyri, etj) energjetike me rëndësi jetike për secilin popull dhe vend.

A nuk e vërtetojnë mu këtë, luftat në Kosovë, Siri, Irak, Jemen, Afganistan, kriza aktuale në Venecuelë, kundërshtimet e ashpra rreth furnizimit të BE me gaz rus etj, ku të gjitha këto vende njihen si vende me burime kolosale të energjisë fosile.

Nuk mundet të thot njeri se zgjedhja e këtyre vendeve për fushëbeteja të të mëdhenjeve të globit, të jetë bërë për Diellin apo erën, çoftë edhe për arsyen e rrezatimit më të madh në shumë nga këto vende?!

Është me rëndësi të ceket se, sa më tepër që burimeve fosile të lëndëve djegëse të energjisë t'u vijë fundi, aq më shumë flitet për rrezikshmërinë që sjell CO₂ dhe gazrat e tjera të çliruara prej tyre, saqë nganjëherë të shkon mendja se vendet që i kanë këto burime sikurse është edhe vendi ynë, duhet të ndihen fajtorë dhe të dënohen pse ato i kanë me bollëk për shumë kohë.

Është e vërtetë absolute, se emetimi dhe çlirimi i dyoksidit të karbonit (CO₂) paraqet rrezik për atmosferën në përgjithësi dhe botën e gjallë në veçanti. Ky rrezik ka lidhje të drejtpërdrejtë me sasinë e çlirimit të tij në atmosferë.

Këto kohë janë mbajtur shumë takime ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit dhe klimës dhe janë lidhur shumë marrëveshje, ku sipas medieve, janë arritur pajtime historik nga të mëdhenjtë në glob, për zvogëlimin e emetimit të CO₂, qoftë duke zvogëluar djegien e lëndëve djegëse, qoftë me zbatimin e teknologjisë moderne "CCS (Carbon Capture and Storage)" etj. Do të ishte mirë, sikur marrëveshjet e nënshkruara nga këso takimesh të viheshin në jetë. Por, bazuar në zhvillimet e derisotme, me gjithë marrëveshjet e arritura për këto qëllime, ajo që dihet nga të gjithë, është se çlirimi i CO₂ në atmosferë ka shënuar vazhdimisht rritje.

Nisur nga e vërteta, se burimet parësore të lëndëve djegëse fosile po shkojnë drejt fundit, del edhe konstatimi se: ata që shqetësohen për klimën dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor, në të vërtetë do të duhej të ndiheshin të lehtësuar, sepse kur s'ka çfarë digjet, s'ka as emetim të CO₂-it. Në anën tjetër, teknologjia moderne e zvogëlimit të tij sikurse janë CCS-TC ka trokitur në derë. Kjo teknologji, që sipas ligjeve të BE që nga viti 2021 do të zbatohet me të madhe, do ta zvogëlojë mjaft mirë emetimin dhe imitimin e CO₂.

Po këtu, shumë nga vendet e zhvilluara u kanë vënë drynin burimeve të veta të energjisë nga lëndët djegëse fosile dhe furnizohen tjetërkah. Nga kjo nuk ta merr mendja se "shqetësimet" për mjedisin apo vënia e drynit të rezervave të tyre të burimeve konvencionale bëhen vetëm për shkak të CO₂!

Me sa duket, qëllimi i paceskur i shqetësimeve, me emrat arsytues "mjedisi" apo "klima", për më tepër gjendet te shterimi i burimeve energjetike!

Qëllimi e arsyeton mjetin! Burimi: Libri Energjia 2018 (A.Begolli)

- **Pse Gjermania po e braktisë djegien e qymyrit ndersa Kosova po e rritë ?!**

Me qëllim të mbrojtjes së klimës dhe mjedisit (sikurse thuhet), Gjermania është shteti i parë në botë që ka vendosur ta braktisi djegjen e qymyrit për nevojën përfitimi të energjisë, duke e respektuar kështu marrëveshjen e Parisit 2015, e cila parasheh që deri në vitin 2050 emetimi i gazrave serë në atmosferë të zvoglohet për 85%, krahasuar me vitin 1990. Qëllimi është që temperatura e ngrohjes globale të kufizohet në të paktën 2°C. Për të arritur këtë qëllim, Gjermania do të duhet të zbatojë plotësisht tërheqjen e planifikuar të djegies së qymyrit deri në vitin 2038 sikurse ka vendosur kohët e fundit një komision federal qeveritar duke i pushuar nga puna rreth 130 TC me qymyr sa shkruhet që aktualisht ekzistojnë në gjermani dhe japin mbi 40% të energjisë së gjithmbarshme që përfitohet nga të gjitha burimet e energjisë në këtë shtet.



*Braunkohletagebau in Welzow
(Lausitz, Brandenburg) Spiegel-online*

*Mihja e qymyrit për TC-Kosova A & B
kek-energy.com/divizioni-qymyrit*

Shtrohet pyetja:

Janë vërtetë klima dhe mjedisi faktorët vendimtar që e shpejtojnë këtë hap kolosal të shtetit më të fortë industrial në Europë dhe njërit ndër më të fortit në botë për ta ndërprerë përfitimin e energjisë nga qymyri, apo fshihen edhe faktor të tjerë, kur dihet që Gjermania me teknologjinë e përparuar që e shfrytizon për djegien e qymyrit dhe me ligjet tepër të forta për mbrojtjen e mjedisit, kjo edhe për meritën e partisë së gjelbër, sa dihet, është ndoshta shteti që zë vendin e parë në botë që i kushton rëndësi klimës dhe mjedisit, këtë e tregon edhe fotoja në vazhdim e një TC të kombinuar Qymyr-Gaz në Gjermani ?!



Dr.G.Schmitz
Ansicht eines Kohlekraftwerkes in Werdohl-Elverlingsen

Që të mundemi ti ofrohem një përgjigjeje më të përafërt rreth pyetjes së parashtruar, duhet ti sqarojmë paksa pyetjet në vazhdim :


- **Cili është rreziku i djegies së qymyrit ?**

Se produktet e djegies së lëndëve djegëse fosile sikurse qymyri, nafta, gazi etj., e prishin në një masë klimën dhe mjedisin, kjo është e njohur jo vetëm për shkencën por edhe për opinionin.

Dallimi është se shkenca fletë me shifra ndërsa opinioni me të dëgjua.

Me procesin e djegies, lënda djegëse e çliron dyoksidin e karbonit CO₂, sasia e të cilit varet nga lloji dhe sasia e lëndës djegëse që i nështrohet djegies.

Cila është sasia e CO₂ të çliruar nga djegia e lëndëve djegëse të ndryshme e shprehur në **gr/ kWh e.e** të pëfituar, tregohet në bllok-diagramet në vazhdim.



Burimi- Quelle: Öko-Institut, s. Fritsche (2007)).

Sqarim:

Treguesit e emitimit dhe imitimit të CO₂, edhe për të njëjtat lëndë djegëse, joggjithherë paraqiten të njëjtë. Varet nga cili burim dhe për ç'far qëllimesh përdoren, që d.m.th. se jorrallë edhe këta tregues varen nga interesat politiko-ekonomike sikurse është rasti ende i papërfunduar i vlerave të gazrave dalëse në industrinë e mëdha automobilistike.

Grafikët e mësipërm tregojnë se CO₂ i çliruar nga djegia e lignitit (**Braunkohle- Kraftwerk**) si p.sh. në TC me kondensim(TC-Kosova A) arrinë sasinë deri **1.153 gr / kWh e.e** në krahasim

me gazin natyror i cili çliron mbi 2 herë më pak CO₂ për të njëjtin përfitim energjie sikurse tregohet më lartë.

Se kjo sasi çlirimi e CO₂ nga djegia e sasisë së nevojshme të qymyrit për përfitimin e 1kWh-energji elektrike nga TC me kondensim është e lartë dhe e dëmshme për klimën dhe mjedisin është e pakundërshtueshme, aq më tepër për vendet e industrializuara ku shifrat e djegies së qymyrit janë shumë të larta.

Veç klimës, nxjerrja dhe djegia e qymyrit e dëmtonë rëndë mjedisin jetësor, me prishjen e sipërfaqeve të tëra të tokave bujqësore, pyjeve dhe shkretërimin e sipërfaqeve të tëra nga deponimi i mbeturinave të djegies si hiri, pluhuri etj. sikurse tregojnë pamjet në vazhdim pikërisht nga TC-Kosova A & B.



Pamje nga ajri e TC-Kosova (A & B), me tymin, avullin dhe kodrat e hirit për rreth.

Burimi: fb.

Duke u nisur nga e vërteta se janë tre faktorë përcaktues të furnizimit me energji:

1. Furnizimi i sigurtë dhe i pandërprerë
2. Qmimi i arsyeshëm
3. Ruejtja e mjedisit dhe e klimës,

Prap lind pyetja :

Mbesin këta faktor të pacenuar edhe me daljen nga qymyri të aq shumë TC që Gjermanisë i sigurojnë mbi 40% plotësim të nevojave për energji?!

1. Furnizimi i sigurtë dhe i pandërprerë

Vetëm burimet fosile të energjisë (qymyri, nafta, gazi urani etj), sigurojnë furnizim të pandërprerë me energji.

Burimet e ripërtitëshme të energjisë me bazë energjinë e drejtpërdrejtë apo të tërthortë diellore, nuk e kanë këtë mundësi, ngase nuk ka Diell dhe erë vazhdimishtë, ndërsa akumulimi nuk del gjithëherë i mundshëm teknikisht dhe i arsyeshëm ekonomikisht.

Mbi këtë bazë, burimet e ripërritëshme janë të suksesshme, vetëm kur i kanë pranë burimet fosile të energjisë.

Kjo mos(siguri) e mundshme, që lind me daljen nga djegia e qymyrit, është shqetsimi kryesor i politikës gjermane

Dhe këtu si gjithëherë, lypet mendimi i shkencës, i përfaqësuar nga institutet prestigjioze, si p.sh. instituti **Energy-Brainpool**, **fraunhofer institut** etj., në bazën e së cilit mendim pastaj vendos politika.

Në këtë rast, shkenca vjenë me studimet perkatëse se nuk paraqet problem largimi nga qymyri ngase janë qysh kohë në pritje shumëTC me gaz në Gjermani dhe Austri, që vetëm e presin sinjalin për ta filluar punën.

Kjo do të thotë se projekti gjigand i furnizimit te Gjermanisë dhe BE me gaz natyror rus në përfundim e sipër, nuk është i ri!

Gjithashtu, Gjermania njihet si vend i eksportimit të energjisë në masën rreth 10%, dhe vend i importimit të qymyrgurit.

2. Qmimi i arsyeshëm

Edhe ecuria e qmimeve sipas studimeve përkatëse do të ruhet, ngase do të shtohen dhe do të përkrahen investimet për shfrytëzimin e burimeve të ripërritëshme të energjisë.

Duke qenë se Gjermania është vetë prodhuese e teknologjisë së përsosur për shfrytëzimin e të gjitha llojeve të burimeve të energjisë, cili do që të jete çmimi i kësaj teknologjie, del i arsyeshëm sepse gjithçka mbetet brenda shtetit (***Wertschöpfung***).

3. Ruejtja e mjedisit dhe e klimës,

Në bazë të analizave dhe duke u nisur nga e vërteta se Gjermania njihet edhe si eksportuese e rrymës pikërisht për faktin se mbi 40% e saj përfitohet nga qymyri në një anë dhe ngritja e vazhdueshme e teknologjisë për shfrytëzimin e burimeve të ripërritëshme të energjisë me qendër rëndese gjeneratorët e erës, del se ky faktor, edhe me daljen nga djegia e qymyrit permirsohet dukshëm.

Nga sa shihet dhe tregojnë zhvillimet, nga të tre faktorët kryesor të furnizimit me energji të cekur më lartë, Gjermania e përmbush në tërësi faktorin e parë- **Furnizimi i sigurtë dhe i pandërprerë**, i cili njëherit është edhe faktori kryesor që mundëson nivelin e lartë të zhvillimit industrial dhe standardin e lartë të jetesës në këtë shtet.

Dhe ky faktorë sikurse tregojnë analizat, mbështetet kryesisht në furnizimin me gaz nga federata ruse, edhe pse gazi natyror nuk bënë pjesë në burimet primare të ripërritëshme të energjisë dhe është njëherit ndër tre faktorët kryesor botëror me bazë konvencionale(qymyri, nafta , gazi), që e prishin klimën dhe mjedisin, sa rreth 1/3 e dëmtimit nga qymyri për përfitim të njëjtë energjie.

- Çka është (Nord Stream 2) rrjedha 2 e Veriut ?



Rrjedha e veriut 2(Nord Stream 2), është projekt në realizim e sipër i furnizimit të BE me qendër Gjermaninë me gaz natyrorë nga federata ruse mes detit baltik me një gjatësi tubacioni 1244 Km.

Sasia vjetore e gazit që mundet të përcillet në BE është 55 Miliard m³ = 70.000 MWh-fuqi elektrike .Ky projekt sipas të dhënave kushton rreth 7 Miliard €.

Rëndësia e këtij projekti është me domethënje strategjike, ngase në të ardhmen përfshinë edhe shumë shtete tjera jashtë BE, duke kaluar gjithashtu nëpër detin dhe territorin shqiptar sikurse tregohet edhe në hartë.

Mu me këtë projekt, lidhet edhe qështja e DETIT shqiptar, të falur greqise(sa flitet dhe shkruhet), e të cilën qështje, politika shqiptare tashmë e ka heshtur! Edhe më strategjik për shqiptarët këtë projekt e bëjnë rezervat dhe resurset e gazit dhe naftës në Shqipëri në tërësi, dhe posaqërishtë në këtë zonë detare në veqanti (sa flitet se ka aty).



Präsident [Dmitri Medwedew](#) eröffnet offiziell das [Rohrverlegen](#) in der [underwater section](#), 9. April 2010

Presidenti i atershëm Rus [Medwedew](#) me 9 Prill 2010 duke hapur zyrtarisht fillimin e punimeve të gazsjellësit Rusi - Gjermani.

Die größten Pipelines, die Erdgas aus Russland in die EU transportieren
Burimi: https://de.wikipedia.org/wiki/Nord_Stream#/media/File:Major_russian_gas_pipelines_to_europe.png

Ka shumë kundërshtime për këtë projekt gjigand jo vetëm jashtë BE, por edhe brenda sajë , ngase secili shtet niset nga interesat e veta sot dhe në të ardhmen.

Përcillni disa pamje në vazhdim me sqarimet përkatëse, të cilat tregojnë në vetën e parë se cila vërtetë është pesha e burimeve energjetike !

Këto kundërshtime, nuk vijnë nga kushdo, por vijnë nga ma të mëdhenjët e globit që kane rezerva, resurse dhe siguri energjetike më tepër se gjithë të tjerët, megjithate donë të mbisigurohen!



14. Januar 2019, 19:58 Uhr Nord Stream 2

Die USA drohen, Deutschland lässt bauen

SHBA kërcënon, Gjermania vazhdon punën

Zwei solcher 300 Meter langen Schiffe sind gerade dabei, die Leitungen der Nord Stream 2 in der Ostsee zu verlegen. (Foto: Sean Gallup/Getty Images)

Dy anije të tilla prej 300 metrash janë në proces të vendosjes së linjave të Nord Stream 2 në Detin Baltik. (Foto: Sean Gallup / Getty Images)



Die geplante Pipeline Nord Stream 2 zwischen Russland und Deutschland ist hoch umstritten. Der US-Botschafter droht deutschen Firmen, die an dem Projekt beteiligt sind, mit Konsequenzen.

Tubacioni i planifikuar Nord Stream 2 midis Rusisë dhe Gjermanisë është shumë i diskutueshëm. Ambasadori i SHBA kërcënon kompanitë gjermane të përfshira në projekt me pasoja.

Burimi: www.sueddeutsche.de/wirtschaft/nordstream-putin-gas-1.4286911



Deutsche Wirtschaft fordert neue Partnerschaft mit Russland

11. Januar 2019, 15:58 Uhr

↓
Ekonomia gjermane bën thirrje për partneritet të ri me Rusinë

Burimi: <https://deutsche-wirtschafts-nachrichten.de/thema/nord-stream-2/>



Merkel: Deutschland will Flüssiggas aus den USA kaufen

23. Januar 2019, 21:18 Uhr

↓
Merkeli: gjermania dëshiron të blejë Gaz të lënoët nga Sh.B.A

Furnizimi i sigurtë me energji nuk njih qmim dhe kufi.

Në të njëjten kohë, Gjermania nga nivelet më të larta shtetërore (Kancelarja Merkel),kërkon partneritet rreth furnizimit me gaz natyror rus dhe gaz të lëngët Amerikan, me qëllim që ti ruaj rezervat dhe resurset vetjake të qymyrit për kohë mungese të burimeve primare të energjisë fosile në shterim e sipër.

Kjo tregon se udhëheqjet shtetërore duhet ta njohin në hollsi strategjinë e politikës energjetike. Në të kundërtën, mu ato vetë, bëhen rreziku i fundosjes së vendeve të tyre! Dhe mu kjo po ndodh me kombin shqiptar !

Se kundërshtimet rreth burimeve primare-fosile energjetike nuk kanë të ndalur, tregonë edhe konferenca ndërkombtare mbi sigurinë botërore mbajtur në Mynih të Gjermanisë nga 15-17 Shkurt 2019 dhe debati i ashpër në mes të nënpresidentit Amerikan **Mike Pence** dhe kancelarës Gjermane **Angela Merkel** lidhur me projektin Ruso-Gjerman **Nord Stream 2 Rrjedha 2 e Veriut** për furnizimin e Gjermanisë dhe BE me gaz rus mes detit Baltik.

1. Sicherheitskonferenz in München: Mike Pence warnt Deutschland wegen Nord Stream 2

Im Streit um das deutsch-russische Pipeline-Projekt Nord Stream 2 richtete Pence eine Warnung an Deutschland. „Wir können die Verteidigung des Westens nicht garantieren, wenn unsere Bündnispartner sich vom Osten abhängig machen.“ Die USA wollten ausdrücklich allen Nato-Partnern danken, „die sich klar positioniert haben gegen Nord Stream 2“, sagte Pence. Die EU forderte er zur Anerkennung des venezolanischen Interimspräsidenten Juan Guaidó auf. Die Europäische Union solle „Juan Guaidó als den einzig rechtmäßigen Präsidenten Venezuelas anerkennen.“ Der venezolanische Staatschef Nicolás Maduro sein „ein Diktator, der kein Recht mehr auf die Macht hat“.



Angela Merkel und Mike Pence auf der 55. Münchner Sicherheitskonferenz. © dpa / Sven Hoppe

2. Merkel verteidigt bei Münchner Sicherheitskonferenz auch Nord Stream 2

Merkel verteidigte in diesem Zusammenhang die umstrittene russisch-deutsche Gas-Pipeline Nord Stream 2 durch die Ostsee.

Die Abhängigkeit Europas von russischem Gas hänge nicht davon ab, ob die Pipeline gebaut werde oder nicht. „Ein russisches Gasmolekül bleibt ein russisches Gasmolekül, egal, ob es über die Ukraine kommt oder ob es über die Ostsee kommt“, sagte sie.

1. Konferenca e sigurisë në Mynih: Mike Pence paralajmëron Gjermaninë rreth Nord Stream 2

Në debatin për projektin gjermano-rus të tubacionit Nord Stream 2, Pence dërgoi një paralajmërim në Gjermani.

"Ne nuk mund të garantojmë mbrojtjen e Perëndimit nëse aleatët tanë varen nga Lindja."

SHBA-ja në mënyrë specifike donte të falënderonte të gjithë partnerët e NATO-s "të cilët janë pozicionuar në mënyrë të qartë kundër Nord Stream 2", tha Pence.

Ai i bëri thirrje BE-së të njohë Presidentin e përkohshëm të Venezuelës Juan Guaidó. Bashkimi Evropian duhet të "njohë Juan Guaidó si presidenti i vetëm legjitim i Venezuelës". Kreu i Venezuelës Nicolás Maduro do të jetë "një diktator i cili nuk ka të drejtë për pushtet".

2. Merkel gjithashtu mbron Nord Stream 2 në Konferencën e Sigurisë në Mynih

Merkel mbrojti në këtë kontekst, tubacionin e diskutueshëm rus-gjerman të gazit Nord Stream 2 përmes Detit Baltik.

Varësia e Evropës ndaj gazit rus nuk varet nëse gazsjellësi ndërtohet apo jo.

"Një molekulë ruse e gazit mbetet një molekulë ruse e gazit, qoftë nëse vjen përmes Ukrainës apo përmes Baltikut," tha ajo.

Vetëm këto pak pamje dhe kundërshtime nga udhëheqësit e superfuqive dhe interesimi i tyre deri në kërcënim për burime konvencionale të energjisë, bëjnë të kuptohet se lufta për energji është e vazhdueshme dhe po ashpërsohet me shterimin e këtyre burimeve, por kjo luftë nuk bëhet për burime diellore të energjisë edhe pse ajo më tepër përmendet në fjalorin politik sesa në ate teknik edhe pse Dielli është aty miliarda vite e do të jetë edhe miliarda të tjerë.

- **Çka do të thot Nord stream 2 - Rrjedha 2 e Veriut krahasuar me qymyrin e Kosovës ?!**

55 Miliarda m³ gaz / vit = me 70.000 MWh- fuqi elektrike = 600.000.000,00(gjashqindmillion) MWh / vit -fuqi elektrike

Llogaritur sipas qmimeve qe paguajn shpenzuesit familjar në gjermani duket sa vijon:

55 Miliarda m³ gaz x 0,7€ = 38,5 Miliard €/ vit

I shndrruar në energji elektrike

600 Milion MWh/ vit x 300€ = 180 Miliarda (€)

Pra kjo është afërsisht vlere vjetore e gazit rus e shndrruar në para për të dy llojet e shpenzimit, si gaz apo energji elektrike gjithherë sipas qmimit që paguan shpenzuesi gjerman.

- **Çfarë do të thotë qymyri i Kosovës po të krahasohet me këto vlere ?!**

Do të thotë shumë, shumë,..., shumë,..

14 Mlrd. Tonelata qymyr të Kosovës kanë vlerë primare - energjetike të paktën:

≈ 60Mlrd. MWh si qymyr i parapërgatitur për djegie me një vlerë > 4 MWh/ ton.

Po ta llogarisim me qmimin që paguan shpenzuesi gjerman do të fitojmë: shumën:

60Mlrd. MWh x 300€ = 1.8¹³ = 18000 Miliard (€)

Shprehur në vite do të thot se vlere energjetike e qymyrit të Kosovës është sa 100 her vlere energjetike e sasisë vjetore të gazit rus qe rrjedhe në BE përmes gazsjellësit Nord Stream 2 !!! që i ka alarmuar më të fuqishmit e globit!

Përfundim-përmbledhje:

Qëllimi i kësaj analize nuk është njohja e opinionit shqiptar me projekte të hueja pavarësisht cila është pesha dhe përmasat e tyre.

Qëllimi është që duke parë luftrat, kundërshtimet deri në kërcënime mes të të mëdhenjëve të globit për projekte të ndryshme energjetike sikurse p.sh Nord Stream etj, politika jonë, intelegjenca, akademite e shkencave,..., dhe rrjedhimisht populli shqiptar, të vetdijsohen dhe të ndërgjegjësohen në nivel kombtar, ta kuptojnë se jetojnë në vendin me pasuritë më të mëdha natyrore të të gjitha llojeve, të cilave duhet tua dijnë rëndësinë që kanë për sot e mot, sepse janë shtylla të sigurisë kombtare, dhe të dijnë ti ruajn për interesa të sotme dhe të gjeneratave që vijnë e mos ti falin për një copë bukë pasuritë multimiliardëshe duke bërë veten jo vetëm objekt përqeshjeje por edhe nënqimimi të skajshëm.

- Mbi këtë bazë, qeveria e Kosovës urgjentisht ta çfuqizoj vendimin për të të ashtuquaturin TC-"Kosova e re", edhe me çmimin e pagimit të denimit për prishje kontrate sepse vendit do ti kushtoj tepër, tepër më pak se sa lejimi i ngritjes së këtij TC kontraverz, i cili TC jo se paraqet far zgjidhjeje energjetike për vendin por njëherit është vetlidhja më e keqe dhe humbje historike për vendin dhe popullin shqiptar !
- Kjo për faktin se Kosova me këtë TC ngarkohet me borgje, e fal qymyrin, e paguan rrymën edhe më tepër se sa është çmimi i tregut etj., për ta mar hirin, pluhurin, dhe gërmadhat e shkaktuara nga ai TC kur nuk i duhet pronarit të tij!
- Politika në këtë plan, si duket është e këshilluar mbrapshtë dhe duhet të ndihmohet pa humbur kohë nga intelegjenca në fakultetet përkatëse, gjithsesi edhe me ndonje simpozium kombtar dhe ndërkombtar, ku të shoshiten nevojat e vendit për energji dhe zgjidhja më e përshtatshme për plotësimin e tyre që mundet të bëhet pa as më të voglin dyshim nga specialistët vendor në nivel kombtar.
- Kosova nevojat e veta për energji veq përfituesve ekzistues me bazë konvencionale apo të ripërtritëshme të burimit primar të energjisë, mundet lehtë ti përmbush me disa centrale të vegjël dhe të kombinuar të cilët munden të ngritën nga vetë investuesit vendor gjithashtu në nivel kombtar.
- Shteti amë Shqipëria të kyqet në këtë plan duke i renditur punet ne planin energjetik dhe fusha tjera të interesit gjithkombtar.

Autori: Abdullah Begolli Inxh.i dipl i termoenergjetikës

begolli-solar@ hotmail.de

